



<http://kk.rks-gov.net/ferizaj>

DREJTORIA E BUJQËSISË DHE PYLLTARISË
UPRAVA ZA POLJOPRIVREDU
DEPARTMENT OF AGRICULTURE

Adresa: Dëshmorët e Kombit p.n

DATA/DATUM/DATE	25.04.2024
11 NR/BR.	11/21
PËR/ZA/TO	Tabelën e shpalljeve
NGA/OD/FROM	z. Burim Bajrami Drejtor i Drejtorisë për Bujqësi
LËNDA/PREDMET/SUBJECT	Thirrje për aplikim



Thirrje për aplikim

Drejtoria për Bujqësi - Ferizaj në bazë të vendimit nr.11/07 të datës 27.02.2025 në përkrahje të zhvillimit të bujqësisë për vitin 2025 do të fillojë procedurat për implementimin e projektit: **Furnizimi i fermerëve me serra dhe sistemin e ujitjes pikë-pikë.** Furnizimi do të bëhet për ngritjen e serrave me sipërfaqe prej **50m²**.

Në këtë subvencionim përfshihet komplet konstrukcioni i serrës, folija, sistemi i ujitjes pikë-pikë, transporti dhe të gjitha punët rreth montimit të serrës.

Përfitues mund të jenë fermerët që i plotësojnë këto kritere:

- Të jetë banor i komunës së Ferizajt,
- Parcela ku do të ngritet serra duhet të jetë në teritorin e komunës së Ferizajt,
- Të ketë aplikuar sipas kushteve të kërkuara,
- Të posedoj tokë të përshtatshme për kultivimin e perimeve në serra,
- Të ketë mundësinë për ujitje,

Në kushte të barabarta përparësi do të kenë:

- Familjet që nuk kanë përfitur më parë serra apo subvencione të tjera nga DpB-si,
- Familjet me gjendje të vështirë ekonomike,
- Familjet me asistencë sociale (që duhet të dëshmohet me dokument zyrtar nga organi përkatës),
- Femrat kryefamiljare,
- Familjet me anëtarë që vuajnë nga sëmundje kronike apo invaliditet (të dëshmohet me dokument nga organi përkatës),
- Personat që kanë aplikuar me datë më herët
- **Fermerët e interesuar për ngritjen e serrës do të aplikojnë në Zyrën e Shërbimit të Qytetarëve-kati përdhësë- Komuna Ferizaj.**

Dokumentacioni i nevojshëm për aplikim:

- 1.Kopjen e letërnjoftimit,
- 2.Certifikatën e bashkësisë familjare,
- 3.Fletëaplikacionin e plotësuar (mirret në Zyrën e Shërbimit të Qytetarëve),
- 4.Dëshminë kadastrale për pronësi (fletën poseduese origjinal jo me te vjeter se 6 muaj) për parcelen ku do të ngritet serra.

Afati për aplikim fillon nga data **25.04.2025** deri më **09.05.2025**